



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 52 /2012
Prishtinë, më 28.02. 2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZRPK; Gëzim Kolgeci – USAID/BEEP.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 23.02.2012;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike;
5. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për emërim e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Hashim Deshishku – Në cilësinë e raportuesit, propozoi që pika e tretë e rendit të ditës të shtyhet në mbledhjen e radhës, për arsye se Oda Ekonomike e Kosovës ka kërkuar të sjellë disa komente.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit, ku miratuan Rendin e ditës, duke hequr pikën e tretë (3) “Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike”.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 23.02.2012

Procesverbali nga mbledhja e datës 23.02.2012 u miratua pa vërejtje

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike

Kryetari – Kërkoj që edhe për këtë Projektligj të vazhdohet me procedurat sikur me projektligjet tjera, ku propozoi që të formohet një grup i punës prej tre anëtarëve për ta shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike.

Dhe Kuvendit ia parashtroi këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike.

Komisioni, pas debatit, nxori këtë

V E N D I M

- 1. U formua grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike.*
- 2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Teuta Sahatqija- raportuese, Zenun Pajaziti dhe Berat Buzhala.*
- 3. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij.*
- 4. Grupi i punës, në bashkëpunim me njësinë koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

4. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për emërim anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Kryetari - Tha se për këtë pikë të rendit të ditës, Kryesia e Kuvendit, me Përfundimin e datës 20.02.2012, ka ngarkuar Komisionin që ta shqyrtojë Propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime. Për këtë kërkoi nga deputetët e Komisionit që të vendosin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për shqyrtim të mëtutjeshëm në seancë plenare.

Myzejene Selmani - pasi që kemi dy propozime për dy kandidatë, kërkoi që ky Propozimvendim i Qeverisë për emërim të anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, t'i kthehet prapa Qeverisë, sepse sipas mendimit të saj, asnjëri prej të dy (2) të propozuarve nuk i plotëson kushtet sipas CV-së. I pari ka konflikt interesi, sepse punon në Bankën Botërore me një kontratë me kohëzgjatje si konsulent afatgjatë. Ndërsa, kandidati i dytë, sipas CV-së së tij, edhe pse ka titullin doktor i shkencave teknike, nuk ka përgatitje profesionale në sektorin e energjisë, por në atë të makinerisë.

Lutfi Zharku - Theksoi se pajtohet me deputeten znj.Selmani, që Propozimvendimi për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji t'i kthehet Qeverisë, për arsyet e theksuara më lart. Sepse kemi të bëjmë me një bord shumë profesional, i cili duhet të marrë vendime shumë profesionale në fushën e energjisë.

Kryetari – Në bazë të Ligjit, nuk kemi të bëjmë me konflikt të interesit për asnjërin prej kandidatëve të propozuar, sepse kanë përgatitje dhe kualifikime të larta, ku besoj se kanë për ta kryer punën në mënyrë profesionale.

Berat Buzhala – Sa i përket çështjes së konfliktit të interesit për kandidatin e parë, kjo çështje mund të zgjidhej, në rast se do të zgjedhej anëtar i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, sepse ai jep dorëheqje nga Banka Botërore ku është konsulent.

Myzejene Selmani - theksoi se, derisa kandidati i parë që ka kontratë me Bankën Botërore dhe e mbikëqyrë sektorin e energjisë duke marrë informacione në KEK, KOSTT dhe ZRRE, atëherë këtu kemi të bëjmë me konflikt të hapur interesi.

Sala Berisha – Shala - Tha se në Ligjin për rregullatorin e energjisë, nuk specifikohet se është konflikt i interesit në qoftë se kandidatët e propozuar janë duke punuar diku. Kërkoi nga anëtarët e Komisionit që ta dërgojnë në seancë plenare për shqyrtim Propozimvendimin e Qeverisë, sepse do të kemi vakuum në kohën kur duhet të merren vendimet për çështjet që kanë bëjnë me privatizimin e distribucionit.

Teuta Sahatqija – Tha se te çështja e emërimit të anëtarëve të bordeve nëpër agjenci të pavarura, ne duhet të mendojmë në radhë të parë për interesin e vendit që anëtarët e bordeve duhet të jenë vërtet kandidatë profesionistë, që mund të japin kontributin e tyre në fushën e energjisë, duke e ruajtur pavarësinë e marrjes së vendimeve për funksionim sa më të mirë të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Hashim Deshishku – Tha se për kandidatin e parë, derisa punon në Bankën Botërore, dhe siç dihet, ky institucion do ta mbikëqyrë projektin për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re” ka konflikt të interesit.

Komisioni, pas debatit, me pesë(5) vota kundër, katër (4) për dhe një (1) abstenim, nxori këtë

Përfundim

Nuk miratohet Propozimvendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me të propozuarit për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, z. Krenar Bujupi dhe z. Ahmet Latifi, dhe për kryesues z. Enver Halimi.

Dhe Kuvendit ia parashtroi këtë

R e k o m a n d i m

Të mos miratohet Propozimvendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me të propozuarit për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, z. Krenar Bujupi dhe z. Ahmet Latifi, dhe për kryesues z. Enver Halimi.

5. Të ndryshme

Çështje vijuese

Myzejene Selmani – Ripërsëriti kërkesën që në një mbledhje të radhës të ftohet z. Besim Beqaj, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe të njoftojë lidhur me privatizimin e distribucionit të Korporatës Energjetike të Kosovës - KEK-ut.

Kryetari - Tha se për këtë çështje do të kontaktojmë me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe shumë shpejt do të ftohet z. Besim Beqaj, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, që të njoftojë lidhur me privatizimin e distribucionit të Korporatës Energjetike të Kosovës - KEK-ut.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit